



RENOVA[®]

Innovation & Performance

RENOFIX 60

EU-LISTA E SIGURISË

Sipas Rregullores (EC) 1907/2006 (REACH),
(EC) 1272/2008 dhe (EC) 453/2010

KREU 1

Identifikimi i substancës ose përzierjes dhe i kompanisë

Emri tregtar	RENOFIX 60
Përdorimi i substancës / përzierjes	Llaç bazë gëlqereje dhe çimentoje. Projektuar për trajtim të plotë të sipërfaqeve të jashtme dhe të brendshme.
Prodhuesi / Furnizuesi	RENOVA, Xhepcist, Tetove, MK T: +389 (0)44 487 300 F: +389 (0)44 487 200 e-mail: info@renova.com.mk
Importues	
Njoftime të rëndësishme	Në rast të një kërcënimi për shëndetin, konsultohuni me mjekun ose telefononi shërbimin mjekësor emergjent në 194

KREU 2

Identifikimi i rrezikut

Klasifikimi i një substance ose përzierje

Klasifikimi sipas Rregullores Nr. 1272/2008 (CLP):



Çon në dëmtime të rënda të syve

RREZIK



Shkakton acarim të lëkurës

Mund të shkaktojë reaksione alergjike të lëkurës

KUJDES

Efektet e rrezikshme fizike dhe kimike për shëndetin e njeriut dhe mjedisin jetsorë

Nuk ka rreziqe të mëtejshme.

Elemente karakteristike

Mbani larg nga fëmijët

Shmangni thithjen e pluhurit

KONTAKTI ME LËKURËN: Lani me shumë sapun dhe ujë

Masat paraprake:

Vishni doreza mbrojtëse / veshje mbrojtëse / mbrojtje të syve / mbrojtje të fytyrës

KONTAKTI ME SYTË: Shpërlani tërësisht me ujë për disa minuta

Nëse zhvillohet acarimi i lëkurës, kërkoni këshilla mjekësore

RENOFIX 60

EU-LISTA E SIGURISË, sipas Rregullores (EC) 1907/2006 (REACH),
(EC) 1272/2008 dhe (EC) 453/2010

Rreziqe të tjera

Kur lënda e thatë bie në kontakt me ujin, formohet një tretësirë e fortë alkaline. Si rezultat i alkalitetit të lartë, llaçi i lagësht mund të shkaktojë acarim të lëkurës dhe syve. Shmangni kontaktin e zgjatur me përzierjen (p.sh. kur qëndroni mbi një llaç të lagur) ekziston rreziku i dëmtimit serioz të lëkurës. Pluhuri i krijuar nga përzierja e thatë mund të irritojë traktin respirator.

Substancat vPvB: E pazbatueshme.

Substancat PBT: E pazbatueshme.

KREU 3

Përbërja / informata mbi përbërësit

Informata mbi përbërësit

Ky produkt është një përzierje e ngjitësve inorganikë, mbushësve dhe aditivëve të padëmshëm

Informata për përbërësit e përzierjes

Komponentët e rrezikshëm sipas Rregullores CLP dhe klasifikimit shoqërues:	8% - 13% Portland Cement CAS 65997-15-1
	⚠ STOT SE kat.3 H335 (Mund të shkaktojë acarim të frymëmarrjes)
	⚠ Skin Irrit. kat.2 H315 (Shkakton acarim të lëkurës)
	⚠ Eye Dam. kat.1 H318 (Shkakton dëmtime serioze të syve)
	4% - 7% Gëlqere (Hidroksid Kalciumi) CAS 1305-62-0
	⚠ STOT SE kat.3 H335 (Mund të shkaktojë acarim të frymëmarrjes)
	⚠ Skin Irrit. kat.2 H315 (Shkakton acarim të lëkurës)
	⚠ Eye Dam. kat.1 H318 (Shkakton dëmtime serioze të syve)
Përbërësit e tjerë (> 20%):	50% - 100% Gur gëlqeror (karbonat kalciumi) CAS 1317-65-3

KREU 4

Masat e ndihmës së parë



Përshkrimi i masave të ndihmës së shpejtë

Informacione të përgjithshme:	Nuk është përshkruar përdorimi i pajisjeve të posaçme mbrojtëse, por duhet të shmangët kontaktin e drejtpërdrejtë me vetë produktin.
Kur thithen:	Hiqni burimet e pluhurit dhe furnizoni ajër të pastër. Nëse personi nuk ndihet mirë, kërkoni ndihmë mjekësore menjëherë dhe tregojuni atyre etiketën.
Kontaktimi me sytë:	Mos i fërkoni sytë sepse kjo mund të shkaktojë dëmtime shtesë. Ngrini qerpikët, lani me ujë të pastër 20 minuta. Nëse është e mundur, përdorni një tretësirë izotonike (p.sh. 0.9% NaCl). Konsultohuni me një mjek - okulist.

RENOFIX 60

EU-LISTA E SIGURISË, sipas Rregullores (EC) 1907/2006 (REACH),
(EC) 1272/2008 dhe (EC) 453/2010

Kur gëlltitet: Shpëlajeni gojën me ujë dhe pini deri në 2.5 dl ujë në gllënjka të vogla. Mos shkaktoni të vjella, kërkonte kujdes mjekësor menjëherë.

Kontakti me lëkurën: Menjëherë lani vendin me ujë dhe sapun. Nëse acarimi i lëkurës vazhdon, thirrni një mjek.

Simptomat dhe efektet më të rëndësishme / akute dhe të vonuara

Kur vjen në kontakt me lëkurën shkakton inflamacion të rëndësishëm, skuqje, mpiksje ose kore. Gjatë kontaktit me sytë produkti mund të shkaktojë lëndime serioze, siç është lëndimi i retinës ose dëmtimi i irisit. Produkti përmban çimento. Kur është në kontakt me ujin ose lagështinë, çimento krijon reaksion alkalik, prandaj shmanguni kontaktit me sytë apo lëkurën.

Trajtimi mjekësor emergjent dhe trajtimi i posaçëm

Në rast aksidenti ose nëse nuk ndiheni mirë, menjëherë kërkonte ndihmë mjekësore (Tregoni një Udhëzues të Përdoruesit ose Fletën e të Dhënave të Sigurisë).

KREU 5

Masat kundër zjarrit

Rreziqet që dalin nga substanca:

Produkti nuk është eksploziv ose i ndezshëm dhe nuk përshpejton djegien e produkteve të tjera. Në rast zjarri, mund të gjenerohet pluhur inorganik. Shmangni formimin e pluhurit. Me ujin formon reaksion alkalik.

Mjetet për shuarje:

Produkti nuk digjet në asnjë gjendje (e thatë ose si një përzierje). Prandaj, aparatet dhe metodat kundër zjarrit duhet të përshtaten me mjedisin.

Këshilla për zjarrfikësit:

Asnjë masë e veçantë nuk kërkohet. Uji i ndotur nga shuarja e zjarrit nuk duhet të derdhet në sistemin e kanalizimit. Mbetjet e zjarrit dhe uji i ndotur duhet kujdesur në përputhje me rregulloret zyrtare.

KREU 6

Masat gjatë derdhjes së rastësishme / rrjedhjes

Procedurat për Siguri Personale:

Shmangni formimin e pluhurit dhe thithjes së tij. Shmangni kontaktin me sytë dhe lëkurën. Vëzhgoni kufijtë e ekspozimit në profesional. Veshini pajisjet personale mbrojtëse (Kreu 8).

Masat për mbrojtjen e mjedisit jetsorë:

Parandalimi i depërtimit në tokë. Parandalimi i rrjedhjeve në ujërat nëntokësore ose në sistemin e ujërave të zeza.

Procedurat e Largimit:

Materiali i derdhur të mblidhet dhe vendoseni në një depo të përshtatshme, dhe nëse është e mundur përdorni përsëri. Shmangni formimin e pluhurit. Mos e fshini në të thatë. Në se gjatë pastrimit paraqitet pluhur atëherë shmangeni ate dhe përdorni roba mbrojtëse. Lejoni që llaçi të ngurtësohet dhe pastaj hiqeni. Materiali i grumbulluar i mbeturinave duhet të trajtohet sipas procedurave të përshkruara në Kapitullin 13.

RENOFIX 60

EU-LISTA E SIGURISË, sipas Rregullores (EC) 1907/2006 (REACH), (EC) 1272/2008 dhe (EC) 453/2010

KREU 7

Trajtimi dhe ruajtja

Masat për trajtimin e sigurt

Trajtimi special nuk kërkon ndonjë procedurë të veçantë. Shmangni kontaktin me sytë dhe lëkurën dhe shmangni formimin dhe depozitimin e pluhurit. Siguroni ajrosje të mirë / nxjerrjen e ajrit në vendin e punës. Mos hani ose pini gjatë punës. Vishni veshje mbrojtëse personale (Shihni Kapitullin 8 për pajisjet mbrojtëse të rekomanduara). Produkti nuk duhet të përdoret pas datës së skadimit.

Kushtet e ruajtjes së sigurt

Mbajeni produktin larg nga fëmijët dhe kafshët. Ruani në një vend të mbyllur mirë, të thatë dhe të freskët larg ushqimit, pijeve dhe ushqimit të kafshëve. Të ruhet në temp. + 5C, të mbrojtur nga ngricat dhe ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj diellit, uji dhe lagështisë. Siguroni ventilimin e duhur të ambienteve.

KREU 8

Kontrollet e ekspozimit / mbrojtja personale

Parametrat që duhet të monitorohen

Vlerat kufitare të përbërësve që kërkojnë mbikëqyrje në vendin e punës:

- **Portland Cement, CAS 65997-15-1**
MDK (MK): Vlera afatgjatë: 10* 4** mg/m³ (*pluhur total; **pluhur respirator)
AGW (DE): Vlera afatgjatë: 5 E mg / m³, DFG
- **Gëlqere (Hidroksid Kalciumi), CAS 1305-62-0**
MDK (MK): 5* mg/m³ (*fraksion i thithshëm)
IOELV (EU): Vlera afatshkurtër: 4* mg/m³, Vlera afatgjatë: 1* mg/m³, (*pluhur respirator)
AGW (DE): Vlera afatgjatë: 1E mg/m³, 2(I);Y, EU, DFG

DNEL limitet e ekspozimit: Inhalacion

- **Gëlqere (Hidroksid Kalciumi), CAS 1305-62-0**
DNEL Efekt afatgjatë: 1 mg/m³ (Konsumator), 1 mg/m³ (Punonjës)
DNEL Efekt afatshkurtër: 4 mg/m³ (Konsumator), 4 mg/m³ (Punonjës)

PNEC limitet e ekspozimit: /

Masat paraprake personale, pajisjet mbrojtëse dhe procedurat emergjente

Mbrojtja gjatë frymëmarrjes:



Përdorimi i masave efektive për kontrollim të pluhurit për të siguruar përputhjen me vlerat maksimale të punës. Nëse ekziston rreziku i tejkalimit të vlerave maksimale të ekspozimit, rekomandohet veshja e maskës mbrojtëse për gojë dhe hundë (lloji FFP2 sipas EN 149).

Mbrojtja e lëkurës:



Vishni veshje mbrojtëse me mëngë të gjata, si dhe këpucë mbrojtëse të papërshkueshëm nga uji. Rekomandohet që veshjet mbrojtëse të mos jenë të përshkueshme nga uji. Mos lejoni që llaçi i freskët të futet në këpucë ose çizme.

Mbrojtja e duarve:



Vishni doreza rezistente ndaj fërkimit, uji dhe kemikalet sipas EN 374. Nuk është e nevojshme të përdorni doreza kimike rezistente kur përgatitni dhe përdorni përzierjet e përgatitura tashmë (Kategoria 3).

RENOFIX 60

EU-LISTA E SIGURISË, sipas Rregullores (EC) 1907/2006 (REACH),
(EC) 1272/2008 dhe (EC) 453/2010

Mbrojtja e syve:



Në rast rreziku të spërkatjes ose formimit të pluhurit, përdorni syze mbrojtëse që janë shtrenguar fort në fytyrë. (EN 166).

Masat e përgjithshme mbrojtëse dhe higjienike:

Në çdo ndërprerje të punës, lani duart, lani mjetet - spahtulla, mistri, kovë, mikser, etj, dhe mbani rrobat e punës ndaras, veç e veç. Shmangni kontaktin me sytë dhe lëkurën. Të ruhet larg ushqimit, pijeve dhe ushqimit të kafshëve. Mos hani ose pini gjatë punës.

Udhëzime shtesë për përdorimin e sistemeve teknike

Për të parandaluar formimin e pluhurit, është e nevojshme të përdorni sisteme të mbyllura, të tilla si sillos, maqinë suvatimi ose mikser me shtesa të veçanta për të parandaluar formimin e pluhurit.

KREU 9

Vetitë fizike dhe kimike

Pamja	Pluhur
Ngjyra	Gri të lehta
Era	/
pH (20°C)	> 11 Tretje e ngopur në ujë
Pika e shkrirjes / ngrirje	> 1300 °C
Ndezshmëri	Produkti është jo i ndezshëm
Pika e vlimit / intervali i vlimit	/

Temperatura e dekompozimit	> 825°C në CaO dhe CO ₂
Temperatura e djegëjes	/
Densiteti	1.410 - 1.520 kg/m ³
Viskoziteti	/
Kufiri i shpërthimit	Produkti nuk është eksploziv
Karakteristikat oksiduese	Asnje
Tretshmëria në ujë	Minimum i tretshëm
Përmbajtja e lëndës së ngurtë	100%

KREU 10

Stabiliteti dhe reaktiviteti

Produkti është i qëndrueshëm në kushtet normale të përdorimit dhe magazinimit. Produkte të rrezikshme gjatë dekompozimit nuk njihen. Reagimet e rrezikshme nuk dihen. Shmangni depërtimin e ujit dhe lagështisë gjatë ruajtjes. Produkti i lagësht është alkalik dhe reagon me acide, kripëra amoniumi dhe metale themelore, psh. Alumini, Zinku, Bronzi. Reagimi me metale themelore krijon hidrogjen.

KREU 11

Të dhëna toksikologjike

Të dhënat mbi efektet toksikologjike

Informata toksikologjike në lidhje me përzierjen: Gjatë vlerësimit të efekteve toksikologjike të ekspozimit ndaj përzierjes, duhet të merren parasysh efektet e përqendrimit të substancave të tij individuale.

RENOFIX 60

EU-LISTA E SIGURISË, sipas Rregullores (EC) 1907/2006 (REACH), (EC) 1272/2008 dhe (EC) 453/2010

Informata toksikologjik mbi përbërësit kryesorë të përzierjes:

Lëkura: Cimentoja irriton lëkurën dhe fytin. Mund të shkaktojë inflamacion ose reaksione alergjike në lëkurë, p.sh. skuqje dhe plasaritje. Kontakti i zgjatur ose fërkimi me lëkurën mund të shkaktojë dëme serioze në lëkurë. Hidroksidi i kalciumit (Gëlqere) irriton lëkurën.

Sytë: Kontakti i drejtpërdrejtë me çimento mund të shkaktojë inflamacion dhe dëmtim të kornesë. Kontakti me sasi të mëdha çimentoje të thatë ose të lagësht mund të rezultojë në dëmtim serioz të syrit. Hidroksidi i kalciumit (Gëlqere) mund të shkaktojë dëme serioze në sy.

Inhalacion: Nuk ka rrezik.

Kancerogjene: Nuk ka rrezik.

Mutacion: Nuk ka rrezik.

Toksiciteti riprodhues: Nuk ka rrezik.

STOT SE - Ekspozimi një herë: Ekspozimi ndaj pluhurit të çimentos mbi vlerën maksimale të ekspozimit profesional mund të çojë në acarim të sistemit të frymëmarrjes. Hidroksidi i kalciumit (Gëlqere) irriton organet e frymëmarrjes.

STOT RE - Ekspozimi i shumëfishtë: Ekspozimi afatgjatë ndaj pluhurit të çimentos mbi kufijtë e ekspozimit profesional mund të çojë në kollitje, vështirësi në frymëmarrje dhe ndryshime kronike obstruktive të frymëmarrjes. Në përqendrime të ulëta nuk u vërejtën efekte kronike.

Toksiciteti akut: Kontakti afatgjatë i lëkurës mund të shkaktojë dëme serioze. Individët mund të zhvillojnë ekzemën e lëkurës pas ekspozimit ndaj çimentos me lagështi.

Të dhëna shtesë toksikologjike:

Shih Kreun 16 (literatura)

KREU 12

Të dhëna për mjedisin jetësor

Toksiciteti

Eko-toksiciteti: Produkti nuk është i dëmshëm për mjedisin. Nuk e ndotë ujin. Vetëm, për shkak të rrezikut të rritjes së pH, sasi të mëdha të produktit nuk guxojnë të lëshohen në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Biodegradimi: Nuk tretet lehtë

Qëndrueshmëria dhe degradueshmëria: Një produkt inorganik nuk mund të hiqet nga uji me përdorimin e procedurave biologjike të pastrimit

Potencial për akumulimin e biologjik: Nuk grumbullohet në organizma.

Lëvizshmëria në tokë: Minimalisht i tretshëm

Rezultatet nga vlerësimi i PBT dhe vPvB

Substancat PBT: E pazbatueshme

Substancat vPvB: E pazbatueshme

Efekte të tjera të dëmshme

Nuk ka të dhëna shtesë.

RENOFIX 60

EU-LISTA E SIGURISË, sipas Rregullores (EC) 1907/2006 (REACH), (EC) 1272/2008 dhe (EC) 453/2010

KREU 13

Menaxhimi i mbeturinave

Metoda për trajtimin e mbeturinave



Nuk duhet të hidhet së bashku me mbeturinat shtëpiake. Nuk guxon të derdhet në kanalizime. Veproni në përputhje me rregulloret lokale dhe kombëtare dhe në përputhje me rregulloren Europiane dhe shtojcat e tyre.

Paketimi i papastër (Mbështjellës)

Të trajtohet në përputhje me rregulloret për menaxhimin e mbeturinave. Mos e hidhni paketimin e zbrazët në afërsi, por vendosni në një vend të caktuar posaçërisht në vendin e ndërtimit, në përputhje me marrëveshjen për bashkëpunim me kompanitë lokale përgjegjëse për trajtimin e mbeturinave.

KREU 14

Të dhënat e transportit

ADR/RID Produkti nuk klasifikohet si mall i rrezikshëm në transportin rrugor dhe hekurudhor

IMO/IMDG Produkti nuk është klasifikuar si mall i rrezikshëm në transportin detar

ICAO/IATA Produkti nuk është klasifikuar si mall i rrezikshëm në transportin ajror

Nuk është e rrezikshme për mjedisin jetsorë.

KREU 15

Informacion rregullator

Rregulloret që lidhen me sigurinë, shëndetin dhe mjedisin jetsorë

Udhëzime (EU) 2012/18

Rregulloret kombëtare: Rregullore për kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës së punonjësve nga reziqet lidhur me ekspozimin ndaj kimikateve "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 46/2010. Ti përmbaheni dispozitave dhe rregulloreve lokale dhe kombëtare.

Rregulloret tjera, kufizime dhe ndalesat

- RL 98/24 / EC (Mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve nga agjentët kimikë)
- RL 2000/39 / EC (Kufizimet indikative për ekspozimin profesional)
- Direktivë 2006/8 / EC
- Rregullorja (EC) 1907/2006 (REACH)
- Rregullorja (EC) 1272/2008 (CLP)
- Rregullorja (EC) 790/2009 (1 ATP CLP) dhe (EU) 758/2013
- Rregullorja (EC) 453/2010 (Shtojca I)
- Direktivë (EU) 286/2011 (2 ATP CLP)
- Direktivë (EU) 618/2012 (3 ATP CLP)
- Direktivë (EU) 487/2013 (4 ATP CLP)
- Direktivë (EU) 944/2013 (5 ATP CLP)

RENOFIX 60

EU-LISTA E SIGURISË, sipas Rregullores (EC) 1907/2006 (REACH),
(EC) 1272/2008 dhe (EC) 453/2010

KREU 16

Informata të tjera

Literatura dhe burimet e të dhënave:

1. NIOSH - Regjistri i efekteve toksike të substancave kimike (1983)
2. ECDIN - Rrjeti i të dhënave dhe informatat mbi hemikalet ekologjike - Qendra e Përbashkët Kërkimore, Komisioni Europian
3. SAX'S - Vetitë e rrezikshme të materialeve industriale

Shkurtesat dhe akronimet:

RID: Rregulloret lidhur me transportin hekurudhor ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme

ADR: Konventa Europiane për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme

IMDG: Kodi detar ndërkombëtar për mallrat e rrezikshme

IATA: Shoqata ndërkombëtare e transportit ajror

GHS: Sistemi i harmonizuar global për klasifikimin dhe etiketimin e hemikaleve

ELINCS: Lista evropiane e hemikaleve të raportuara

CAS: Shërbimi kimik i abstrakteve (Departamenti i Shoqërisë Amerikane Kimike)

CLP: Klasifikimi, paketimi dhe etiketimi

DNEL: Niveli i shfaqur pa efekt (REACH) LC50

PBT: Konstante, bioakumulativ dhe toksik

vPvB: Shumë konstant dhe shumë bioakumulativ

LTE: Ekspozimi afatgjatë

PNEC: Përqendrimi i vlerësuar pa asnjë efekt

CTE: Ekspozimi afatshkurtër

STEL: Afati i shkurtër i ekspozimit

CTOT: Toksiteti i synuar i organeve

TLV: Kufiri i ekspozimit profesional

OEL: Vlera e kufizuar evropiane

WGK: Klasa e rrezikut nga ujti

TSCA: Ligji mbi Kontrollin e Substancave Toksike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Informata shtesë:

Të dhënat e shkruara në fletën e të dhënave të sigurisë bazohen në informatat që janë aktualisht në dispozicion. Ato janë të vlefshme vetëm për produktin e specifikuar dhe nuk janë garancë për vetitë.

Prodhuesi nuk është përgjegjës për përdorimin dhe ekzekutimin e procedurave të përshkruara të përdoruesit të produktit. Përdoruesi i produkteve tona, në përgjegjësinë e tij, duhet ti respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi që nuk janë të shënuara në këtë Fletë të Sigurisë.

Të dhënat në listën në sigurisë i referohen vetëm kërkesave të sigurisë lidhur me produktin dhe nuk janë të vlefshme në kombinim me materiale ose procese të tjera që nuk janë dhënë në manualin e përdoruesit.

Data e prodhimit: 06. 2019.

Data e lëshimit të mëparshëm: /

Data e edicionit të përditësuar (botim 00):

Ndryshimet në kapitujt: /

RENOFIX 60

EU-LISTA E SIGURISË, sipas Rregullores (EC) 1907/2006 (REACH),
(EC) 1272/2008 dhe (EC) 453/2010



RENOVA MAQEDONI

Xhepcisht / Tetovë

T: +389 44 487 300, F: +389 44 487 200
info@renova.com.mk

RENOVA SHQIPËRI

Vore / Tiranë

T: +355 48 301 909, F: +355 48 301 908
tirana@renova.com.mk

RENOVA KOSOVË

Gureza / Ferizaj

T:+381 290 310 222, F:+381 290 310 444
ferizaj@renova.com.mk

COMPANY CERTIFIED BY



EN ISO 9001

Certificate No: **FM 503328**

www.renova.com.mk